



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 16.04.2026

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 495, të datës 16.04.2026, paraqitur nga Adriatik Zeqiri – Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, bazuar në nenin 13, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (GZ Nr.28/2008), nenin 53, paragrafi 3 i Ligjit me Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 44, të Statutit të Komunës, Nr.98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Plotësohet vendimi me Nr.581, të datës 31.03.2026, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, si në vijim:
 - 1.1.Për kategorinë e trajnerëve për trajnimin e mësimdhënësve, lejohet aplikimi për përfitim nga subvencionet edhe për trajnerët që nuk janë qytetarë të Komunës së Fushë-Kosovës, për arsye të nevojës për angazhimin e ekspertëve profesionalë dhe sigurimin e cilësisë në realizimin e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve.
2. Plotësohet pika 3 e vendimit me Nr. 581 i datës 31.03.2026, me tekstin si në vijim:
 - 2.1.Kriteret minimale sipas fushave të studimit përfshin fakultetet me programet e studimit në institucionet publike dhe të gjitha drejtimet në kolegjet private të arsimit të lartë të akredituara në Republikën e Kosovës.
3. Vendimi me Nr. 581 të datës 31.03.2026 plotësohet me pikën si në vijim:
 - 3.1 Zgjatet afati për aplikim edhe për dhjetë (10) ditë pune, përkatësisht nga data 17.04.2026 deri më 30.04.2026, me qëllim mundësimin e aplikimit për të gjithë kandidatët e interesuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit, nga Kryetari i Komunës.

Akti i dorëzohet:

- 1x Kryetarit të Komunës
- 1x Drejtorisë së Arsimit
- 1x Arkivit

Kryetari i Komunës
Valon Prebreza

